

KATALOGU I PUBLIKIMEVE

2008

të Bankës së Shqipërisë



p u b l i k i m e

të Bankës së Shqipërisë



PËRMBAJTJA

HYRJE	5
RAPORTET PERIODIKE TË BANKËS SË SHQIPËRISË	7
ARTIKUJ TË BOTUAR NË BULETININ EKONOMIK TË BANKËS SË SHQIPËRISË	11
MATERIALE DISKUTIMI	15
BOTIME TË TJERA TË BANKËS SË SHQIPËRISË	24
BOTIME EDUKATIVE	25
ARTIKUJ TË PUNONJËSVE TË BANKËS SË SHQIPËRISË, TË PUBLIKUAR NË SHTYPIN VENDAS	30



p u b l i k i m e

të Bankës së Shqipërisë



HYRJE

Banka e Shqipërisë boton një sërë publikimesh të cilat janë me interes si për profesionistët në fushën e bankingut e në atë të biznesit, ashtu edhe për akademikët e për publikun e gjerë. Për t'ju ndihmuar të orientoheni më lehtë, çdo vit ne botojmë një Katalog, i cili përmbledh jo vetëm titujt e publikuar gjatë vitit, por jep edhe një përshkrim të shkurtër të përmbajtjes së tyre.

Katalogu i Publikimeve të Bankës së Shqipërisë 2008 është një përmbledhje e raporteve periodike mbi politikën monetare, sistemin bankar e atë financiar, sektorin e jashtëm të ekonomisë; punëve kërkimore; materialeve edukative dhe informative të përgatitura nga punonjësit e bankës qendrore për publikun gjatë vitit të sapombyllur.

Me këtë rast, ju rikujtojmë se botimet e Bankës së Shqipërisë janë të disponueshme për këdo që është i interesuar dhe shpërndahen sipas një liste, e cila përfshin administratën publike, bankat tregtare, institucione të ndryshme, biblioteka dhe këdo tjetër që ka paraqitur kërkesë për t'i marrë ato. Në format elektronik, këto publikime mund t'i gjeni edhe në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë www.bankofalbania.org/web/Lista_e_Publikimeve_2610_1.php

Lexim të këndshëm!



p u b l i k i m e

të Bankës së Shqipërisë



RAPORTET PERIODIKE TË BANKËS SË SHQIPËRISË

RAPORTI VJETOR

Raporti Vjetor i Bankës së Shqipërisë përmban një analizë të gjendjes ekonomiko-financiare të vendit si dhe veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë gjatë një viti. Ai gjithashtu, bën një përshkrim të zhvillimeve në ekonominë botërore dhe impaktin e saj mbi ekonominë vendase; të zhvillimeve në tregjet monetare, mbikëqyrjen bankare si dhe të veprimtarive të tjera të Bankës së Shqipërisë; pasqyrat dhe llogaritë financiare, të shoqëruara nga opinioni i kontrollorëve, lidhur me gjendjen financiare të Bankës së Shqipërisë.

RAPORTET E POLITIKËS MONETARE

Vendimmarrja politike e Bankës së Shqipërisë është një e drejtë ekskluzive e Këshillit Mbikëqyrës të saj. Ky proces vendimmarrjeje bazohet në analizat dhe në parashikimet që çdo muaj të vitit janë pjesë e njërit prej raporteve të mëposhtme të politikës monetare:

1. Raporti Tremujor i Politikës Monetare, i cili përshkruan zhvillimet monetare për tremujorin e parë dhe për nëntëmujorin. Një vend të rëndësishëm përbën qëndrimi që duhet mbajtur në të ardhmen.
2. Raporti Gjashtëmujor i Politikës Monetare. Ky raport analizon dhe vlerëson zhvillimet ekonomike e financiare të ekonomisë shqiptare gjatë gjashtë muajve të parë ose të fundit të një viti të caktuar. Në varësi të këtyre

RAPORTI
VJETOR 2007
Banka e Shqipërisë



zhvillimeve, të ndikimit të tyre në inflacionin e periudhës së shqyrtuar dhe të pritjeve për të ardhmen jepet dhe qëndrimi i politikës monetare të Bankës së Shqipërisë.

3. Dokumenti i Politikës Monetare. Ky dokument shpjegon publikisht në terma sasiorë objektivin e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë, duke përcaktuar kohëzgjatjen e tij, duke përshkruar kriteret dhe treguesit të cilët do të udhëheqin vendimmarrjen e Bankës së Shqipërisë në këtë fushë, si dhe duke paraqitur kuadrin e instrumenteve që do të përdoren për përmbushjen e objektivit.

RAPORTI VJETOR I MBIKËQYRJES

Raporti Vjetor i Mbikëqyrjes përgatitet nga Departamenti i Mbikëqyrjes dhe përmban: një analizë vjetore të veprimtarisë së sistemit bankar dhe të mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë; një kuadër të plotë të ndryshimeve rregullatore mbikëqyrëse në përshtatje me standardet dhe praktikën më të mira ndërkombëtare; statistika dhe informacione mbi subjektet e licencuara nga Banka e Shqipërisë si dhe çështje të ecurisë së sistemit bankar.

RAPORTI I STABILITETIT FINANCIAR

Raporti i Stabilitetit Financiar u publikua për herë të parë në vitin 2008 dhe do të jetë një dokument i përvitshëm, që analizon zhvillimet me rëndësi të sistemit financiar gjatë një viti kalendarik dhe evidenton faktorët që përfaqësojnë rrezik sistematik. Ai bën identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve me të cilat ndeshet sistemi financiar dhe infrastruktura e tij, për t'i dhënë autoriteteve publike mundësinë që të identifikojnë

RAPORTI VJETOR
I MBIKËQYRJES
2007
Banka e Shqipërisë

RAPORTI
I STABILITETIT
FINANCIAR
2007



masat përkatëse për korrigjimet e nevojshme. Për hartimin e raportit, shfrytëzohen të dhëna që disponohen në Bankën e Shqipërisë, si dhe shkëmbehet informacion me autoritete të tjera që mbikëqyrin veprimtarinë e tregut financiar.

BULETINI I BILANCIT TË PAGESAVE

Buletini Vjetor i Bilancit të Pagesave analizon hollësisht zhvillimet e sektorit të jashtëm të ekonomisë shqiptare, për vitin përkatës. Në këtë botim, bëhet një analizë e bilancit të pagesave sipas zërave të veçantë të llogarisë korente dhe llogarisë kapitale e financiare. Ai përmban analiza të detajuara të zhvillimeve në tregtinë e jashtme sipas grupmallrave dhe shteteve, analiza të ecurisë së shërbimeve, të të ardhurave, të transfertave korente dhe transaksioneve në llogarinë kapitale dhe financiare. Nëpërmjet një përshkrimi sintetik, ofron për përdoruesit e pasqyrës së bilancit të pagesave njohje me konceptin "bilanc pagesash", duke prezantuar njëkohësisht burimet dhe metodologjinë e përdorur në hartimin e Bilancit Shqiptar të Pagesave. Buletini përmban, gjithashtu, një aneks statistikor ku do të gjeni seri kohore të dhënash për zërat kryesorë të bilancit të pagesave.

RAPORTI STATISTIKOR

Raporti Statistikor është një botim i përmuajshëm që përgatitet nga Departamenti i Statistikës dhe përmban të dhëna statistikore për sektorin real, sektorin financiar, sektorin fiskal dhe sektorin e jashtëm.



BULETINI ZYRTAR

Buletini Zyrtar është botim që përgatitet jo më pak se një herë në muaj dhe përmban të gjitha vendimet e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë me përjashtim të atyre që kanë karakter sekret ose konfidencial, rregullore, deklarata, opinione, rekomandime si dhe çdo akt tjetër me karakter të përgjithshëm, që gjykohen të përshtatshme për t'u botuar.

BULETINI EKONOMIK

Buletini Ekonomik përmbledh analiza, vlerësime që kanë të bëjnë me politikën monetare të Bankës së Shqipërisë si dhe informacione të ndryshme mbi sistemin bankar. Ky publikim ka një frekuencë tremujore dhe përmban: raportet periodike të politikës monetare, që botohen në zbatim të kërkesave të ligjit "Për Bankën e Shqipërisë"; prezencën e administratorëve të Bankës së Shqipërisë në publik; artikuj të ndryshëm që trajtojnë çështje ekonomike, financiare apo juridike; rezultate të vërtetimeve të kryera nga Banka e Shqipërisë; listën e bankave të licencuara për të kryer veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë, adresat dhe kontaktet e tyre; strukturën organizative dhe drejtuesit e Bankës së Shqipërisë (anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës dhe drejtorët e departamenteve).



ARTIKUJ TË BOTUAR NË BULETININ EKONOMIK TË BANKËS SË SHQIPËRISË

BULETINI EKONOMIK - VËLLIMI 11, NR.1, MARS 2008

NJË QASJE E DISIPLINUAR MBI MENAXHIMIN E PORTOFOLIT.
REZART MOLLA, Specialist, Sektori i Operacioneve, Departamenti
i Operacioneve Monetare.

Ky material synon të japë një përshkrim të shkurtër të procesit të tregtimit në përgjithësi dhe hapave nëpër të cilët duhet të kalojë një tregtues dhe/ose menaxher portofoli, në veçanti. Dokumenti titullohet 'T.R.A.D.E.M.A.P', ku çdo shkronjë përfaqëson secilën fazë të administrimit të portofolit, nga konceptimi, ekzekutimi dhe deri te përfundimi i të gjithë procesit. Materiali përshkruan të gjitha fazat me rradhë: (1) T-Tema (anglisht – Theme), (2) R-Shqyrtimi (Review), (3) A-Vlerësimi (Assess), (4) D-Vendimmarrja (Decision), (5) E-Ekzekutimi (Execution), (6) M-Mbikëqyrja/Ndjekja (Monitoring), (7) A-Përshtatja/Reagimi (Adjust), (8) P-Performanca (Performance).

Pas përshkrimit të tetë fazave të procesit të administrimit të portofolit, autori nxjerr përfundimet e tij mbi të gjithë procesin dhe emocionet e forta që ky proces dhe luhatjet e tregut mund të shkaktojnë në mjaft raste tek menaxheri, sjelljet e mundshme të tij dhe pasojat që këto sjellje mund të kenë në performancën e portofolit.



BULETINI EKONOMIK - VËLLIMI 11, NR.2, QERSHOR 2008

INDEKSI I ÇMIMEVE TË HUAJA /VLRAVE NJËSI TË IMPORTEVE SHQIPTARE.

RISAN SHLLAKU, Specialist, Departamenti i Kërkimeve¹.

BULETINI EKONOMIK - VËLLIMI 11, NR.3, SHTATOR 2008

PËRÇIMI I KURSIT TË KËMBIMIT NË SHQIPËRI: EVIDENCË NGA FAKTORËT AUTOREGRESIVË.

KLODIANA ISTREFI, Kryespecialiste, Departamenti i Kërkimeve; dhe VALENTINA SEMI, Specialiste, Departamenti i Politikës Monetare².

MATJE TË REJA TË INFLACIONIT BAZË: PËRDORIMI I TYRE NË PARASHIKIM DHE ANALIZË.

EVELINA ÇELIKU, kryespecialiste; RAJNA HOXHOLLI, specialiste, Departamenti i Politikës Monetare³.

MATJA E FUNKSIONEVE TË IMPORT-EKSPORTIT NË SHQIPËRI ILIR VIKA, Departamenti i Kërkimeve⁴.

BULETINI EKONOMIK - VËLLIMI 11, NR.4, DHJETOR 2008

VROJTIMI I BESIMIT TË BIZNESIT DHE TË KONSUMATORIT - SHPJEGIME METODOLOGJIKE.

Duke filluar nga viti 2002, Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me Institutin e Statistikave, zhvillon me

1 Ky punim është publikuar edhe si Material Diskutimi më vete. Përmbledhjen e tij mund ta gjeni në faqen 20.

2 Ky punim është publikuar edhe si Material Diskutimi më vete. Përmbledhjen e tij mund ta gjeni në faqen 17.

3 Ky punim është publikuar edhe si Material Diskutimi më vete. Përmbledhjen e tij mund ta gjeni në faqen 16.

4 Ky punim është publikuar edhe si Material Diskutimi më vete. Përmbledhjen e tij mund ta gjeni në faqen 21.



një periodicitet tremujor, Vrojtimin e Besimit të Biznesit (VBB) dhe Vrojtimin e Besimit të Konsumatorit (VBK), me synimin për të vlerësuar aspekte të ndryshme të aktivitetit ekonomik të bizneseve dhe të konsumatorëve familjarë. Informacioni i mbledhur nëpërmjet vrojtimeve përdoret për të ndërtuar tregues për sektorë të veçantë të ekonomisë dhe treguesin e tendencës ekonomike. Të dhënat për ndërtimin e këtyre treguesve sigurohen nga realizimi i vrojtimeve të tendencës pranë zgjedhjeve përfaqësuese të bizneseve dhe të konsumatorëve / familjeve të një vendi. Veçoria e këtyre treguesve është se ata rezultojnë nga një informacion bazë i natyrës cilësore, që mblidhet pranë të intervistuarve në lidhje me zhvillimet korente dhe të pritshme në ekonomi.

Informacioni që merret nga treguesit e tendencës apo të besimit përdoret në monitorimin e zhvillimeve ekonomike në periudha korente si edhe në parashikimin e tyre në terma afatshkurtër. Përvoja botërore e përdorimit të këtyre treguesve ka verifikuar se ata kanë rezultuar të suksesshëm në sinjalizimin e pikave të kthesës në ciklin e biznesit. Vlera e shtuar analitike e tyre konsiston në faktin se nëpërmjet këtyre treguesve realizohen analiza mbi zhvillimet në ekonomi përpara publikimit të statistikave zyrtare të periudhave korente. Aftësia për të parashikuar prirjet themelore në ekonomi, rrit ndjeshëm vlerën e treguesve të besimit, kryesisht në vendimmarrje dhe politikëbërje. Në ekonomitë në zhvillim, treguesit e besimit për situatën korente dhe atë të pritshme marrin një rëndësi të veçantë përdorimi, në kushtet e një informacioni statistikor relativisht të vonuar dhe jo të plotë.



ANALIZË VROJTIMI: INVESTIMET E HUAJA DIREKTE NË SHQIPËRI PËR VITIN 2007.

ENDRITA XHAFERAJ, Kryespecialiste, Departamenti i Statistikës.

Investimet e Huaja Direkte (IHD) në Shqipëri vazhdojnë të jenë një burim shumë i rëndësishëm i flukseve të kapitalit si edhe një nga burimet kryesore për financimin e deficitit të llogarisë korente. Njohja e vlerës së saktë dhe natyrës së IHD-ve nënvizon nevojën për statistika të sakta dhe të detajuara në lidhje me to. Matja dhe regjistrimi i IHD-ve në vendin tonë mbetet një sfidë për ofrimin e statistikave cilësore dhe të krahasueshme në vite dhe me ato të vendeve të tjera. Për këtë arsye, Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me INSTAT ka ndërmarrë vrojtime të përvitshme pranë kompanive me kapital të huaj e të përbashkët, që operojnë në Shqipëri.

Në këtë material analizohet ecuria e investimit të huaj direkt në Shqipëri gjatë vitit 2007, duke u bazuar mbi të dhënat e mbledhura nga vrojtimi në shkallë kombëtare mbi kompanitë me kapital të huaj e të përbashkët, zhvilluar gjatë korrikut të vitit 2008. Ky vrojtim është i pesti ndër vrojtimet e ndërmarra për krijimin dhe monitorimin e bazës së të dhënave për IHD-të në Shqipëri.



MATERIALE DISKUTIMI

A ËSHTË I QËNDRUESHËM DEFICITI I LLOGARISË KORENTE? RASTI I SHQIPËRISË.

ALTIN TANKU, Drejtor, Departamenti i Kërkimeve; EVIS RUÇAJ,
Nëndrejtorë, ARGITA FRASHËRI, Përgjegjëse Sektori, Departamenti
i Statistikës.

Ekonomia shqiptare ka ecur përgjatë rrugës së tranzicionit duke gjeneruar rritje të qëndrueshme, inflacion relativisht të kontrolluar dhe deficite të larta të llogarisë korente. Ndërmjet këtyre variablave puna kërkimore dhe përpjekje të tjera studimore janë përqendruar së pari tek rritja dhe kohët e fundit edhe tek inflacioni. Llogaria korente, pavarësisht rolit të saj të rëndësishëm si tregues i nevojshëm për pozicionin e jashtëm të një vendi, ka marrë shumë më pak vëmendje nga kërkuesit dhe akademikët.

Gjatë 15 viteve të fundit, llogaria korente e Shqipërisë ka kaluar në deficite të cilat në shumicën e rasteve kanë shkuar përtej 5përqind të PBB-së, një nivel qëndrueshmërie i pranuar gjerësisht. Ky studim trajton aftësitë e qëndrueshmërisë së deficitit të llogarisë korente, duke u bazuar mbi metodën LRBC të zhvilluar nga Trehan dhe Walsh (1991) dhe të zgjeruar nga Taylor (2002). Autorët kanë marrë në shqyrtim vrojtime tremujore të llogarisë korente për periudhën 1994–2006 dhe testimin e rrënjës së njësisë, për të analizuar qëndrueshmërinë e llogarisë korente. Vëmendje e veçantë i është kushtuar rolit të remitancave në përcaktimin e qëndrueshmërisë së llogarisë korente. Rezultatet e studimit tregojnë se pavarësisht zgjerimit të deficitit kohët e fundit, duket se llogaria korente në periudhën afatgjatë është e



qëndrueshme. Megjithatë, kjo qëndrueshmëri mund të jetë e prekshme, ndaj meriton vëmendjen e autoriteteve shqiptare.

MATJE TË REJA TË INFLACIONIT BAZË: PËRDORIMI I TYRE NË PARASHIKIM DHE ANALIZË.

EVELINA ÇELIKU, kryespecialiste; RAJNA HOXHOLLI, specialiste, Departamenti i Politikës Monetare.

Praktika e matjes së inflacionit bazë ofron një spektër të gjerë metodash. Por a ekziston një metodë perfekte dhe universale për matjen e tij? Deri më sot nuk është konkluduar në një të tillë. Zgjedhja e metodës mbi bazën e së cilës arrihet një seri e përshtatshme për inflacionin bazë është një pikë e debatueshme në rrethet akademike e në ato të bankierëve qendrorë. Bankat qendrore përdorin matje të ndryshme të inflacionit bazë. Në të gjitha rastet synohet të zgjidhen ato metoda që informojnë në mënyrën më të qartë të mundshme vendimmarrësit, agjentët ekonomikë dhe publikun e gjerë mbi prirjen afatgjatë të inflacionit.

Studimi sjell argumente në lidhje me diskutimet e vazhdueshme në Bankën e Shqipërisë mbi temën e parashikimit të inflacionit dhe më konkretisht, mbi atë të përdorimit të inflacionit bazë për parashikim. Në këtë punim autorët paraqesin një set të pasuruar matjesh për inflacionin bazë. Për secilën matje jepen në mënyrë të përmbledhur metodologjitë, përparësitë dhe problemet përkatëse. Në vijim, në bazë të rezultateve të disa kriterëve statistikore të testeve mbi shkallën e persistencës së komponentes bazë, të aftësive parashikuese të matjeve të inflacionit bazë për inflacionin total, bëhen përpjekje për të evidentuar matjet më optimale për t'u përdorur në rastin e Shqipërisë.



B a n k a e s h q
M A T E
D I S K U

MATJE TË REJA TË
PËRDORIMI I TYR
PARASHIKIM DHE
EVELINA ÇELIKU, RA

40926655654654
0679058132051
158069724888
210175208432
47678246537
5654
21002138024
5043654656

MATJA E EFEKTIT BALASSA-SAMUELSON: RASTI I SHQIPËRISË.
EVELINA ÇELIKU, kryespecialiste; RAJNA HOXHOLLI, specialiste,
Departamenti i Politikës Monetare.

Ky material synon të verifikojë praninë e efektit Balassa – Samuelson si dhe ta masë atë në rastin e ekonomisë shqiptare. Eksplorimi i efektit Balassa-Samuelson, përbën një aspekt të rëndësishëm për politikën monetare të ndjekur nga bankat qendrore, sepse ai i vë theksin lidhjes midis produktivitetit relativ të sektorit të tregtueshëm të një ekonomie të vogël e të hapur në terma të sektorit të patregtueshëm të saj, me çmimet relative të këtyre dy sektorëve. Teorikisht, prania e një lidhjeje pozitive do të mbështeste faktin që inflacioni ndikohet nga rritja e produktivitetit relativ.

Autoret e studimit, me ndihmën e modeleve ekonometrike, kanë vlerësuar efektin e brendshëm dhe të jashtëm Balassa-Samuelson mbi inflacionin. Rezultatet treguan se për periudhën e marrë në studim, ekziston një lidhje pozitive ndërmjet produktivitetit relativ dhe çmimeve relative, fakt që mbështet studimin e efektit Balassa – Samuelson në rastin e ekonomisë tonë. Vlerësimet sasiore dëshmojnë se ky efekt ka patur një ndikim të moderuar mbi inflacionin. Materiali paraqet edhe rezultatet e një modelimi më specifik të këtij efekti mbi tendencat e kursit real të këmbimit. Rezultatet e studimit ndihmojnë në eksplorimin e modelit të ekuilibrit të përgjithshëm të kursit të këmbimit në Shqipëri.

PËRCIMI I KURSIT TË KËMBIMIT NË SHQIPËRI: EVIDENCË NGA VEKTORËT AUTOREGRESIVË.

KLODIANA ISTREFI, Kryespecialiste, Departamenti i Kërkimeve; dhe
VALENTINA SEMI, Specialiste, Departamenti i Politikës Monetare.



Me kohë studiues të shumtë janë përpjekur të gjejnë një lidhje të ngushtë midis lëvizjeve në kursin e këmbimit dhe nivelit të çmimeve të një vendi. Në këtë material, autorët vlerësojnë masën dhe shpejtësinë e përcimit të lëvizjeve të kursit të këmbimit në çmimet e konsumit në Shqipëri, me anë të modeleve me vektorë autoregresivë, VAR. Rezultatet e analizave tregojnë se në përgjithësi, për periudhën 1996-2006, përcimi i kursit të këmbimit në çmimet e konsumit në Shqipëri paraqitet i shpejtë dhe pothuajse i plotë. Ndërkohë, analiza e përcimit në periudha të veçanta nxjerr në pah paplotësinë dhe rënien e tij pas viteve 2000. Si justifikues të kësaj sjelljeje evidentohen zhvillimet në strukturat e tregut, stabiliteti i lekut, mjedisi inflacionist dhe besueshmëria në Bankën e Shqipërisë. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se zhvillimet në kursin e këmbimit nuk kanë më rëndësi për formimin e çmimeve të konsumit në Shqipëri.

Nëpërmjet këtij studimi, autorët tregojnë se efekti i kursit të këmbimit në çmime nuk është më lehtësisht i kapshëm nga analiza e drejtpërdrejtë e të dhënave të çmimeve dhe të kursit të këmbimit. Në këto kushte, autoriteti monetar duhet të jetë i vëmendshëm dhe të zgjedhë reagimin e duhur ndaj lëvizjeve në kursin e këmbimit të lekut. Në qoftë se në të ardhmen do të rritet luhatshmëria e lekut, nuk ka garanci që reagimi i ekonomisë dhe i çmimeve të konsumit në veçanti, nuk do të ndryshojë.

METODA ALTERNATIVE TË MATJES SË PRODUKTIVITETIT NË SHQIPËRI.

VASILIKA KOTA, specialiste, Departamenti i Kërkimeve.

Matja e produktivitetit të ekonomisë dhe e hendekut të prodhimit, për arsye të shumta është thelbësore për



të vlerësuar politikat makroekonomike të një vendi. Produktiviteti është treguesi më i mirë i përdorimit të kapaciteteve në ekonomi. Me fjalë të tjera, ai llogarit prodhimin maksimal që një ekonomi mund të gjenerojë, pa shkaktuar inflacion. Hendeku i prodhimit tregon devijimin e prodhimit nga niveli i tij potencial. Gjithashtu, të dy këta tregues janë të rëndësishëm në llogaritjen e rritjes ekonomike.

Ky material diskutimi ka për qëllim të vlerësojë produktivitetin dhe hendekun e prodhimit në Shqipëri, për periudhën 1996-2006. Produktiviteti llogaritet duke përdorur metodat e regresionit linear, filtrin e Hodrick Prescott dhe metodën e funksionit të prodhimit. Rezultatet e të tria metodave krahasohen duke përdorur analiza të mbështetura në të dhëna periodike për të matur ciklin e ekonomisë dhe ashpërsinë e tyre. Këto teste tregojnë se metoda e funksionit të prodhimit llogarit më pak cikle ekonomike me variancën më të ulët. Meqenëse kjo metodë paraqet edhe anën e ofertës së ekonomisë, duket të jetë më e përshtatshme për vlerësimin e produktivitetit në Shqipëri.

ROLI I BANKAVE NË MEKANIZMIN E TRANSMETIMIT MONETAR NË SHQIPËRI.

ILIR VIKA, Departamenti i Kërkimeve.

Ky studim kontribuon me gjetjen e evidencave empirike mbi kanalin e kredisë bankare të politikës monetare në Shqipëri duke përdorur të dhënat individuale të 12 bankave kryesore. Në veçanti, synohet të studiohet nëse ecuria e kredisë bankare ndaj sektorit privat mund të shpjegohet nga ndryshimet në treguesin e politikës monetare, i matur me



normën e interesit të marrëveshjeve të riblerjes njëjavore. Gjetjet empirike sugjerojnë se për periudhën trevjeçare 2004-06 sjellja e kredisë bankare është ndikuar në mënyrë modeste nga vendimet e politikës monetare. Koeficientët e treguesit të politikës monetare janë statistikisht të rëndësishëm dhe me shenjë negative, që mbështet lidhjen teorike midis normës së interesit dhe vëllimit të kredisë. Megjithatë, evidencat empirike për të mbështetur ekzistencën e një kanali të kredisë bankare në Shqipëri janë mikse. Në kundërshtim me teorinë dhe pritjet intuitive në vend, rezultatet e nxjerra tregojnë se bankat e vogla janë më pak të ndjeshme ndaj qëndrimit të politikës monetare se sa ato më të mëdha. Ndërkohë, bankat me likuiditet më të madh duket se janë më të mbrojtura ndaj ndryshimeve të politikës monetare, në linjë me teorinë mbi kanalin e kredisë bankare.

INDEKSI I ÇMIMEVE TË HUAJA /VLRAVE NJËSI TË IMPORTEVE SHQIPTARE.

RISAN SHLLAKU, Specialist, Departamenti i Kërkimeve.

Të dhënat dhe statistikat ekonomike janë elemente themelore për kryerjen e analizave të suksesshme ekonomike dhe për formulimin e politikave ekonomike, si nga sektori publik ashtu dhe nga ai privat. Fatkeqësisht, cilësia e tyre në rastin e Shqipërisë nuk konsiderohet mjaft e kënaqshme për momentin. Në këtë kontekst, ndërtimi i një indeksi të çmimeve të huaja/vlerave njësi të importeve shqiptare shënon një përpjekje të Bankës së Shqipërisë për përmirësimin e të dhënave dhe statistikave ekonomike.

Në përqasjen e propozuar për ndërtimin e indeksit të vlerave të huaja njësi /çmimeve të importeve shqiptare,



autori bazohet në teorinë e indekseve të numrave. Indeksi fillestar përqendrohet në çmimet e importeve shqiptare në tregjet nga ku ato importohen, gjë e cila përjashton efektin e kursit të këmbimit dhe bën që impakti i këtyre dy efekteve mbi tregues të ndryshëm makroekonomikë, të analizohet dhe të llogaritet në mënyrë të veçuar.

MATJA E FUNKSIONEVE TË IMPORT-EKSPORTIT NË SHQIPËRI ILIR VIKA, Departamenti i Kërkimeve.

Ky material diskutimi përdor një model të korrektimit të gabimit, me qëllim matjen e elasticitetit të flukseve të import/eksportit të mallrave drejt/nga Shqipëria kundrejt kërkesës së brendshme (të huaj) reale, zhvillimeve në çmimet relative në vend dhe në botë, si dhe luhatjeve në monedhën vendase. Ky model ka për qëllim të identifikojë nëse flukset tregtare reagojnë në mënyrë të ndryshme ndaj variablave të mësipërm në periudhën afatgjatë dhe në atë afatmesme. Vlerësimi i elasticiteteve të tregtisë bëhet për të parashikuar flukset e ardhshme tregtare dhe për të ndihmuar vendimmarrësit në zgjedhjen midis politikave tregtare dhe alternativave të zhvlerësimit të kursit të këmbimit, me qëllim përmirësimin e bilancit tregtar të mallrave.

Gjetjet empirike të këtij studimi tregojnë se të ardhurat reale (të përfaqësuara nga PBB) janë përcaktuesi kryesor i flukseve tregtare në periudhën afatgjatë, veçanërisht për eksportet. Kjo sugjeron se Shqipëria mund të përfitojë potencialisht nga politikat e nxitjes së eksporteve. Madje, ndryshimet në çmimet relative duket se kanë një ndikim më të madh mbi vëllimin e importit të mallrave sesa kanë luhatjet e kursit të këmbimit. E kundërta qëndron për



ofertën e eksporteve, e cila duket se reagon më shumë dhe më shpejt ndaj ndryshimeve në kursin e këmbimit lek/euro, sesa ndaj çmimeve relative. Krahas vlerësimit të elasticitetit të importeve dhe eksporteve të mallrave për qëllime parashikimi, materiali hedh dritë edhe mbi politikën e brendshme ekonomike, duke synuar kufizimin e deficitit tregtar me pjesën tjetër të botës.

ROLI I KURSIT TË KËMBIMIT NË NJË REGJIM TË INFLACIONIT TË SHËNJESTRUAR.

ALTIN TANKU, Drejtor, ILIR VIKA, Departamenti i Kërkimeve; MARIAN GJERMENI, Drejtor, Departamenti i Operacioneve Monetare.

Ndërkohë që Shqipëria angazhohet të eksplorojë inflacionin e shënjestrUAR, si regjimin e ardhshëm të mundshëm të politikës monetare, me anë të këtij studimi autorët përpunon të analizojnë në detaje elementet e këtij regjimi, të shqyrtojnë lidhjen dhe të vlerësojnë ndikimin e variablave ekonomike mbi inflacionin dhe kursin e politikës monetare. Në të njëjtën kohë, është i rëndësishëm të kuptohet implikimi i këtij regjimi në variablat e tjerë të politikës, ndër të cilët kursi i këmbimit është shumë i rëndësishëm, me ndikim të drejtpërdrejtë mbi inflacionin dhe/ose mbi pritjet e inflacionit. Për rrjedhojë, shqyrtimi i lidhjes mes këtyre dy variablave është i nevojshëm për suksesin e këtij regjimi.

Ky material diskutimi analizon lidhjen ndërmjet kursit të këmbimit dhe inflacionit në Shqipëri. Qëllimi i parë i autorëve të tij është të shqyrtojnë impaktin e ndryshimeve të kursit të këmbimit mbi çmimet e konsumit vendas, e për rrjedhojë mbi inflacion, dhe së dyti, të hedhin dritë mbi reagimin e politikës monetare ndaj ndryshimeve në kursin e këmbimit.



p u b l i k i m e

të Bankës së Shqipërisë

Gjetjet mund të jenë me vlerë për politikëbërësit e bankës qendrore para adoptimit të plotë të regjimit të inflacionit të shënjestruar, për të kuptuar presionet që mund të kenë zhvillimet në tregjet e këmbimit valutor mbi inflacionin dhe pritjet e inflacionit.



BOTIME TË TJERA TË BANKËS SË SHQIPËRISË

ARTIKUJ TË BOTUAR NË BULETININ EKONOMIK TË BANKËS SË SHQIPËRISË GJATË NJË DEKADE

Me rastin e 10-vjetorit të botimit të Buletinit të saj Ekonomik, Banka e Shqipërisë risjell për lexuesit e tij një përmbledhje të të gjitha punimeve që kanë qenë pjesë e Buletinit Ekonomik në këto vite. Duke iu drejtuar kryesisht një auditori profesionistësh, si në fushën e biznesit e në atë të bankingut, por dhe për akademikët e për publikun e thjeshtë, këto punime të specialistëve të Bankës mbajnë formën e artikujve, vrojtimeve dhe studimeve të ndryshme, që analizojnë aspekte dhe zhvillime të institucionit të bankës qendrore, sistemit bankar ose të ekonomisë shqiptare gjatë periudhës në të cilën janë shkruar.

Nisur nga numri i konsiderueshëm i këtyre artikujve, ky botim vjen për publikun i ndarë në tre vëllime sipas periudhave të publikimit të këtyre studimeve, 1998-2000, 2001-2004 dhe 2005-2007. Duam me këtë rast, të tërheqim vëmendjen e lexuesit që këto punime, përveç faktit që shprehin opinione dhe përfundime personale të autorëve, duhen parë edhe të vendosura në kuadrin kohor kur janë shkruar, të lidhura me ngjarjet të cilave u referohen apo me fenomenet që marrin në shqyrtim.



BOTIME EDUKATIVE

NJË GUIDË DREJT LLOGARISË TUAJ TË PARË BANKARE

“Një guidë drejt llogarisë tuaj të parë bankare” paraqet në mënyrë të thjeshtë dhe të shkurtër përfitimet e hapjes së një llogarie bankare. Ajo përshkruan llogaritë bankare që ofrojnë aktualisht bankat tregtare në Shqipëri, si dhe hapat që duhen ndjekur për të hapur një llogari pranë këtyre bankave. Broshura i përgjigjet disa pyetjeve të rëndësishme me të cilat mund të përballet secili gjatë hapjes së një llogarie bankare apo mirëmbajtjes së saj.

GUIDA E STUDENTIT

Kjo broshurë është ideuar për nxënësit e shkollave të mesme, që aspirojnë të vazhdojnë shkollën e lartë. Ajo është shkruar në një gjuhë lehtësisht të kuptueshme nga të gjithë, me qëllim që t’u japë nxënësve njohuritë e nevojshme për të marrë vendime “të drejta” ekonomike para se të nisin universitetin. Faqet dhe rreshtat e kësaj broshure përmbajnë një informacion të përgjithshëm mbi disa nga nocionet dhe instrumentet financiare më të përdorura, si dhe këshilla të thjeshta për miradministrimin e parave.

VLERA E VËRTETË E PARASË

Kjo broshurë është shkruar për të gjithë nxënësit që duan të njihen apo të marrin pjesë në konkursin e përvitshëm



të Bankës së Shqipërisë për shkollat e mesme “Vlera e Vërtetë e Parasë”. Ajo është gjithashtu e dobishme për mësuesit e lëndës së ekonomisë, që për çdo vit shoqërojnë nxënësit e tyre në konkurs, në rolin e udhëheqësve të skuadrës. Broshura, në mënyrë shumë të përmbledhur, i njih lexuesit me konkursin “Vlera e Vërtetë e Parasë”, me atë çka përfaqëson ky aktivitet, përse Banka e Shqipërisë e ka ideuar dhe e organizon atë, llojin e pyetjeve të konkursit, të shoqëruara me shembuj konkretë dhe sigurisht, foto të konkurseve të kaluara dhe pjesëmarrësve të tyre, të cilët tashmë janë miqtë më të rinj të Bankës së Shqipërisë.


PËRSE DUHET TË KENI NJË BUXHET PERSONAL? (RIBOTIM)

Buxheti mund të konsiderohet si hapi i parë për të arritur qëllimet tuaja financiare. Ai ju ndihmon të kontrolloni shpenzimet, duke krijuar mundësi që të shtoni kursimet. Në një farë mënyre buxheti është ndërgjegjja juaj financiare. Ai tregon se sa fitoni dhe sa jeni duke shpenzuar.

Ç’ËSHTË PËR JU STABILITETI I ÇMIMEVE? (RIBOTIM)

Kjo broshurë përshkruan në mënyrë të thjeshtë dhe të detajuar qëndrueshmërinë e çmimeve dhe rëndësinë e saj për ekonominë e një vendi. Në tekst, do të gjeni shembuj të cilët janë marrë nga jeta e përditshme. Kjo broshurë shpjegon edhe konceptet e inflacionit e të deflacionit dhe ndërlikimet që ata sjellin në jetën e secilit.





BANKA E SHQIPËRISË - BANKA JONË QENDRORE (RIBOTIM)

Nëpërmjet një panorame të përgjithshme të historisë, strukturës dhe funksioneve të bankës qendrore, kjo broshurë i prezanton publikut Bankën e Shqipërisë. Si e realizon Banka e Shqipërisë objektivin e stabilitetit të çmimeve, si kontribuon ajo me politikatat e saj, në zhvillimin ekonomik dhe në mirëqenien e vendit dhe të tjerave si këto pyetje, do t'u jepet përgjigje duke shfletuar këtë botim.



NDËRTONI TË ARDHMEN – PLANIFIKONI TË ARDHURAT TUAJA (RIBOTIM)

Ky libërth është ideuar dhe shkruar për t'i ardhur në ndihmë publikut të gjerë në organizimin financiar të jetës së përditshme; në administrimin sa më të mirë të të ardhurave personale; në orientimin drejt mënyrave më të përshtatshme për të shtuar kursimet apo për të rritur fitimet.



HISTORIA E AKULLORES (RIBOTIM)

Duke iu përgjigjur pikëpyetjeve të vogëlushes Albane mbi ndryshimin e çmimit të akullores së saj të dëshiruar, kjo broshurë e thjeshtë shoqëron të gjithë fëmijët e moshës së saj në njohjen me konceptin e inflacionit. Historia e akullores është një shembull i mirë për të kuptuar se si ndikon inflacioni mbi vlerën e parasë me kalimin e viteve dhe çfarë bën Banka e Shqipërisë për ta mbajtur atë nën kontroll.



TË FLASIM THJESHT PËR INFLACIONIN (RIBOTIM)

Ndryshe nga broshura e mësipërme, ky botim i drejtohet një publiku pak më të rritur duke kryer një analizë më të detajuar të inflacionit. Ajo fillon me një historik të shkurtër të konceptit të këmbimit në natyrë të shoqërive të para bujqësore, për të kaluar më pas në matjen e nivelit të çmimeve në ditët tona nëpërmjet Indeksit të Çmimeve të Konsumit, për të përcaktuar normën e inflacionit.



INSTRUMENTET E POLITIKËS MONETARE TË BANKËS SË SHQIPËRISË DHE PROCEDURAT PËR REALIZIMIN E TYRE (E RISHIKUAR)

Një broshurë që shpjegon kuadrin operacional të Bankës së Shqipërisë dhe mënyrën e funksionimit të tij. Duke qenë vijim edhe i një tjetër botimi për këtë qëllim, ajo është përpjekur të shpjegojë më gjerësisht dhe me një gjuhë sa më të kuptuar nga publiku se si funksionon dhe si është i rregulluar ky kuadër.



IBAN-NUMRI NDËRKOMBËTAR I LLOGARISË BANKARE (FLETËPALOSJE)

Numri ndërkombëtar i llogarisë bankare (IBAN) është një standard ndërkombëtar, me anë të të cilit banka identifikon në mënyrë unike çdo llogari bankare të klientëve të saj, me qëllim lehtësimin e procesimit të transfertave. Meqenëse,



nga 1 janari 2010, IBAN-i do të jetë i vetmi standard i numrit të llogarisë së një klienti në Republikën e Shqipërisë, kjo fletëpalosje jep informacion për strukturën dhe përdorimin e tij.

FLETËPALOSJE DHE POSTERA PËR PREZANTIMIN E KARTËMONEDHAVE SHQIPTARE

- Tërheqja nga qarkullimi e kartëmonedhave 100 dhe 200 Lekë.
- Kartëmonedha e re 2000 Lekë.
- Kartëmonedha e re 1000 Lekë.



ARTIKUJ TË PUNONJËSVE TË BANKËS SË SHQIPËRISË, TË PUBLIKUAR NË SHTYPIN VENDAS

RRITJA EKONOMIKE NË FOKUS TË 2008
ADRIAN CIVICI, gazeta "Shqip", 13 janar 2008.

SHKAQET DHE PASOJAT E KRIZËS FINANCIARE NDËRKOMBËTARE
ADRIAN CIVICI, gazeta "Shqip", 27 janar 2008.

REGJISTRIT I KREDIVE PËRMES PROJEKTIT TË BANKËS SË
SHQIPËRISË
ARDIAN FULLANI, gazeta "Republika", 29 janar 2008;
gazeta "Telegraf", 2 shkurt 2008;
gazeta "Probiznes", 8 shkurt 2008.

GLOBALIZIMI, SI PO MODELOHEN UNIVERSITETET
ADRIAN CIVICI, gazeta "Shqip", 3 shkurt 2008.

KRIZA E ÇMIMEVE KËRKON MASA URGJENTE
ADRIAN CIVICI, gazeta "Shqip", 6 shkurt 2008.

KONKURRENCA DHE INTELIGJENCA EKONOMIKE
ADRIAN CIVICI, gazeta "Shqip", 10 shkurt 2008.

SHTETI, TREGU DHE KONKURRENCA – MOTIVET E NDËRHYRJES
PUBLIKE
ADRIAN CIVICI, gazeta "Shqip", 24 shkurt 2008.

DO TË REAGUJMË NDAJ PRESIONEVE INFLACIONISTE
ARDIAN FULLANI, gazeta "Ekonomia", 28 shkurt 2008.

BANKAT SHPESHHERË NUK TREGOJNË KUJDESIN E DUHUR
PËR CILËSINË
ARDIAN FULLANI, gazeta "Ekonomia", 5 prill 2008.

ÇMIMET DHE TREGJETË USHQIMORE QË PO TRONDITIN BOTËN.
A PO JU KUSHTOJMË NE VËMENDJEN E DUHUR?



ADRIAN CIVICI, gazeta "Shqip", 16 prill 2008.

PO SHTOHEN PRESIONET INFLACIONISTE
ARDIAN FULLANI, gazeta "Zëri i Popullit", 23 prill 2008.

LEKSIONET E NJË MODELI TË SUKSESSHËM
ADRIAN CIVICI, gazeta "Shqip", 2 maj 2008.

AKTIVITETET BANKARE E FINANCIARE NË SHQIPËRI DHE
EVROPËN JUGLINDORE
FATOS IBRAHIMI, gazeta "Metropol", 17 maj 2008;
gazeta "Ekonomia", 20 maj 2008.

BANKAT QENDRORE NË FOKUS
ADRIAN CIVICI, gazeta "Shqip", 22 maj 2008.

INFLACIONI KËRCËNON EKONOMINË EVROPIANE
ADRIAN CIVICI, gazeta "Shqip", 1 qershor 2008.

OECD MODERON PESIMIZMIN: KRIZA DREJT FUNDIT?
ADRIAN CIVICI, gazeta "Shqip", 6 qershor 2008.

BIODIVERSITETI, KRIZA E HESHTUR E ZHVILLIMIT
ADRIAN CIVICI, gazeta "Shqip", 11 qershor 2008.

PIKËPYETJET E MËDHA TË ÇMIMIT TË NAFTËS
ADRIAN CIVICI, gazeta "Shqip", 15 qershor 2008.

DOLLARI DHE NAFTA, KRIZA AKOMA JASHTË KONTROLLIT
ADRIAN CIVICI, gazeta "Shqip", 29 qershor 2008.

DILEMAT SHQIPTARE NDAJ EUROS: TË NDËSHKUAR APO
PRIVILEGJUAR?
ADRIAN CIVICI, gazeta "Shqip", 6 korrik 2008.

RRUGËT BANKARE NGA EMIGRANTËT MBETEN TË KUFIZUARA
ARGITA FRASHËRI, gazeta "Ekonomia", 8 korrik 2008.

FMN DHE KRIZA EKONOMIKE
ADRIAN CIVICI, gazeta "Shqip", 19 korrik 2008.



ZHVLERËSIMI: RRUGËTIMI I GJATË I LEKUT
ADRIAN CIVICI, suplementi XXL, gazeta "Shqip", 29 gusht
2008.

"LEKSIONI AMERIKAN" DHE PRIORITETET E POLITIKËS
ADRIAN CIVICI, gazeta "Panorama", 8 shtator 2008.

SISTEMI BANKAR: NXITËS PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK TË
VENDIT
ARDIAN FULLANI, gazeta "Ekonomia", 14 shtator 2008;
gazeta "Republika", 14 shtator 2008;
gazeta "Koha jonë", 14 shtator 2008.

KULTURA BANKARE E FINANCIARE QË NA MUNGON
ADRIAN CIVICI, gazeta "Panorama", 17 shtator 2008.

NJË LEXIM MË REALIST I KLIMËS SË BIZNESIT
ADRIAN CIVICI, gazeta "Panorama", 20 shtator 2008.

DILEMA E FMN APO NEVOJA PËR "TUTOR"?
ADRIAN CIVICI, gazeta "Panorama", 26 shtator 2008.

KRIZA BOTËRORE DHE RREZIQET PËR SISTEMIN TONË
BANKAR
ARDIAN FULLANI, gazeta "Gazeta Shqiptare", 30 shtator 2008;
gazeta "Tirana Observer", 30 shtator 2008;
gazeta "Koha Jonë", 30 shtator 2008.

NEGLIZHENÇA NDAJ TREGJEVE FINANCIARE ËSHTË E
PAFALSHME PËR NE
ARDIAN FULLANI, gazeta "Ekonomia", 1 tetor 2008.

RREZIQET PËR DEVIJIMIN E INFLACIONIT JANË ENDE TË
PRANISHME
ARDIAN FULLANI, gazeta "Ekonomia", 2 tetor 2008.

SI DO TË NDIKOJË KRIZA BOTËRORE NË SHQIPËRI?
ARDIAN FULLANI, gazeta "Tirana Observer", 8 tetor 2008;
Gazeta "55", 8 tetor 2008.



KRIZA FINANCIARE NË EVROPË – APELI I EKONOMISTËVE
ADRIAN CIVICI, gazeta “Panorama”, 9 tetor 2008.

G7, SIGURI PËR BANKAT
ADRIAN CIVICI, gazeta “Panorama”, 13 tetor 2008.

PARATË NË BANKAT E SHQIPËRISË, TË SIGURTA (INTERVISTË E
GUVERNATORIT FULLANI PËR ZËRIN E AMERIKËS)
Botuar në gazetën “Ballkan”, 15 tetor 2008;
gazetën “Ekonomia”, 15 tetor 2008;
gazetën “Albanian Daily Neës”, 15 tetor 2008;
gazetën “Telegraf”, 15 tetor 2008;
gazetën “Ndryshe”, 15 tetor 2008;
gazetën “Standard”, 15 tetor 2008;
gazetën “RD”, 15 tetor 2008;
gazetën “55”, 15 tetor 2008.

NJË NOBELIST “ANTI-KRIZË”
ADRIAN CIVICI, gazeta “Panorama”, 20 tetor 2008.

A NA DUHET NJË STRATEGJI ANTIKRIZË?
ADRIAN CIVICI, gazeta “Panorama”, 27 tetor 2008.

TABUTË QË PO PËRMBYS KRIZA FINANCIARE
ADRIAN CIVICI, gazeta “Panorama”, 3 nëntor 2008.

BANKAT E PARA NË SHQIPËRI (CIKLI “HISTORIKU I BANKAVE NË
SHQIPËRI (1863-1944)”)
KSENOFON KRISAFI, revista “Monitor”, nr.44, 5 nëntor 2008.

SISTEMI BANKAR MBETET KËSHILLTARI MË I MIRË PËR JU
ARDIAN FULLANI, gazeta “Ekonomia”, 13 nëntor 2008.

SISTEMI BANKAR NË DORË TË DREJTËSISË
ARDIAN FULLANI, gazeta “Zëri i popullit”, 18 nëntor 2008.

PRAPASKENAT E BANKËS KOMBËTARE TË SHQIPËRISË (CIKLI
“HISTORIKU I BANKAVE NË SHQIPËRI (1863-1944)”)
KSENOFON KRISAFI, revista “Monitor”, nr.46, 19 nëntor 2008.



PËRBALLË SHIFRAVE: SA SUBJEKTIVË!

ADRIAN CIVICI, gazeta "Panorama", 20 nëntor 2008.

FORCIMI I MASAVE RREGULLATIVE TË KREDIDHËNIES, GARANCI
PËR STABILITET FINANCIAR (INTERVISTË)

ARDIAN FULLANI, gazeta "Ekonomia", 21 nëntor 2008.

ZGJEDHJA E VËSHTIRË: KAPITALIZËM APO DEMOKRACI?

ADRIAN CIVICI, gazeta "Panorama", 24 nëntor 2008.

TEJKALIMI I KRIZËS EKONOMIKE DO TË KËRKOJË KOHËN E
VET

ARDIAN FULLANI, gazeta "Ekonomia", 28 nëntor 2008;
gazeta "Republika", 27 nëntor 2008.

BKSH, SI KONTROLLONTE EKONOMINË SHQIPTARE (CIKLI
"HISTORIKU I BANKAVE NË SHQIPËRI (1863-1944)")

KSENOFON KRISAFI, revista "Monitor", nr.48, 3 dhjetor 2008.

MËSYMJA E BANKAVE TË HUAJA (CIKLI "HISTORIKU I BANKAVE
NË SHQIPËRI (1863-1944)")

KSENOFON KRISAFI, revista "Monitor", nr.49, 10 dhjetor
2008.

EKONOMIA PËRBALLË NJË VITI TË RI TË VËSHTIRË

ARDIAN FULLANI, gazeta "Koha Jonë", 20 dhjetor 2008;
gazeta "Tirana Observer", 20 dhjetor 2008;
gazeta "Zëri i Popullit", 20 dhjetor 2008;
gazeta "Ekonomia", 20 dhjetor 2008.



p u b l i k i m e

të Bankës së Shqipërisë



*Këtë publikim mund ta gjeni edhe në formë elektronike
në adresën:*

www.bankofalbania.org

*Gjithashtu në qoftë se dëshironi të keni kopje të
shkruara të tij mund t'i kërkonit në adresën:*

*Sheshi "Skënderbej" Nr.1 Tiranë Shqipëri,
Tel.: +355-(0)4-2222152;
Faks: +355-(0)4-2223558*

*ose duke dërguar një e-mail në adresën:
public@bankofalbania.org*

Tirazhi: 1000 kopje

